

ВЕРНО НА ОРИГИНАЛОТ
NJËSH ME ORIGINALIN

РЕПУБЛИКА СГ ВЕРНА МАКЕДОНИЈА
RE PUBLIKA E MAQEDONISE SE VERIUT
ЦЕНТАР ЗА СТУДЕНТО ОБРАЗОВАНИЕ И ПОУКА
QENDRA PER ARSIM PROFESSIONAL DHE TRAJNIM

Премени Редит	31-05-2022		
Организаци Nomen	Идентифика Nomen	Датум Dobit	Времетрае Vreme
08	560/18		

Në bazë të nenit 55, paragrafi 1 të Ligjit organizimin dhe punën e organeve të administratës shtetërore („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 58/00, 44/02, 82/08, 167/10 и 51/11 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 96/19 dhe 110/19), neni 38 paragrafi 1 nga Ligji për arsimin e mesëm („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë “ nr. 44/95, 24/96, 34/96, 35/97, 82/99, 29/02, 40/03, 42/03, 67/04, 55/05, 113/05, 35/06, 30/07, 49/07, 81/08, 92/08, 33/10, 116/10, 156/10, 18/11, 42/11, 51/11, 6/12, 100/12, 24/13, 41/14, 116/14, 135/14, 10/15, 98/15, 145/15, 30/16, 127/16, 67/17 dhe 64/18 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 229/20) dhe neni 7 nga Ligji për arsimin e mesëm profesional dhe trajnim („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 71/06, 117/08, 148/09, 17/11, 24/13, 137/13, 41/14, 145/15, 55/16, 64/18 dhe „Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 275/19), ministri i Arsimit dhe shkencës e miratoi Programin e provimeve të moduleve të obligueshme në arsimin e mesëm profesional për profilin arsimor/kualifikimin **Teknik për komunikacion rrugor** nga drejtimi/sektori **Komunikacion/Komunikacion, Transport dhe Magazinim**, në arsimin e mesëm teknik të reformuar.

PROGRAMI PROVIMEVE



PËR MATUREN SHTETËRORE DHE PROVIMIN PËRFUNDIMTAR



MINISTRIA PËR ARSIM DHE SHKENCË
QENDRA SHTETËRORE E PROVIMEVE

QENDRA PËR ARSIM PROFESIONAL DHE TRAJNIM

TEKNIK PËR KOMUNIKACION RRUGOR

Profili/kualifikimi arsimor

ARSIMI I MEËM
PROFESIONAL

Shkup, 2022

1. HYRJE

Programi i provimeve për profilin/kualifikimin arsimor **Teknik për komunikacion rrugor** nga arsimi teknik i reformuar mundëson përgatitjen e provimit të maturës dhe provimit përfundimtarë të cilat janë në funksion të përmirësimit të kualitetit në arsim. Programi i provimeve paraqet bazë për përgatitjen e testeve për maturën shtetërore dhe provimin përfundimtar, me të cilat mundësohet rumbullaksimi i arsimit (certifikimi) dhe regjistrimi i nxënësve në arsimin e lartë (seleksionimi).

Në vitin shkollorë 2019/2020, filloi realizimi i programeve dhe planeve mësimore nga arsimi teknik i reformuar në të gjitha profilet/kualifikimet arsimore nga të gjitha drejtimet/sectorët. Planet mësimore të reformuara janë të dizajnuara në mënyrë modulare, ndërsa programet mësimore janë të përbëra nga njësitë modulare, të paraqitura nëpërmjet një ose më shumë rezultateve të mësimit dhe kriterëve të notimit.

Në përputhje me Konceptin për maturë shtetërore, matura shkollore dhe provimi përfundimtar në shkollat e mesme publike, nxënësi e zgjedh lëndën e tretë zgjedhore nga programet mësimore profesionale nga pjesa zgjedhore.

Në përputhje me planet mësimore të reformuara dhe programet në arsimin e mesëm katërvjeçar, po ofrohet një model i ri i programit të provimeve. Përmbajtja e programit të provimeve pas modelit të reformuar përbëhet nga programet mësimore të obligueshme të moduleve obligative për profilin/kualifikimin arsimor **Teknik për komunikacion rrugor**. Në programin e provimeve kemi dy paketa modulare, ndërsa nxënësit e zgjedhin vetëm njërin.

Programi i provimeve për maturën shtetërore dhe për provimin përfundimtarë nga modulet e obligueshme për arsimin profesional për profilin/kualifikimin arsimor **Teknik për komunikacion rrugor** i përmban komponentët vijuese:

1. Hyrja
2. Qëllimet e provimit
 - 2.1. Qëllimet e përgjithshme të provimit
 - 2.2. Qëllimet e paketës zgjedhore
 - 2.2.1. Qëllimet e paketës zgjedhore një (1)
 - 2.2.2. Qëllimet e paketës zgjedhore dy (2)
3. Përmbajtja e provimit
 - 3.1. Specifikacioni i përmbajtjes dhe aftësitë e programit të provimeve
 - 3.2. Konkretizimi i rezultateve nga mësimi për njësitë modulare
4. Rrjeti i specifikimeve të provimit
 - 4.1. Rrjeti i specifikimeve të paketës zgjedhore një (1)
 - 4.1. Rrjeti i specifikimeve të paketës zgjedhore dy (2)
5. Përshkrimi i provimit
6. Mënyra e notimit
7. Nënshkrimi dhe data e miratimit të programit të provimeve

2. QËLLIMI I PROVIMIT

2.1. Qëllimet e përgjithshme të provimit

Qëllimet e përgjithshme të maturës shtetërore dhe provimit përfundimtarë të moduleve të obligueshme për arsimin profesional për profilin/kualifikimin arsimor **Teknik për komunikacion rrugor** është që të kontrollohen:

- arritja e njohurive për vazhdimin e suksesshëm të arsimit dhe përcaktimi i profesionit të ardhshëm;
- aftësimi për tu kyçur në tregun e punës;
- aftësimi për zbatimin individual të njohurive nga fusha e komunikacionit, transportit dhe magazinimit;
- zbatimi i principeve dhe ligjeve që vlejnë gjatë zgjidhjes së problemeve praktike dhe konkrete nga fusha përkatëse.

2.2. Qëllimet e paketës zgjedhore

2.2.1. Qëllimet e paketës zgjedhore një (1)

Paketa zgjedhore një (1) në programin e provimeve për organizimin e transportit e përbëjnë dy programe mësimore: **Organizimi i komunikacionit rrugor**, që mësohet në vitin e **tretë** dhe **Organizimi i komunikacionit rrugor**, që mësohet në vitin e **katërt**. Në vazhdim janë të definuara qëllimet të dy programeve mësimore që e përbëjnë paketën zgjedhore një (1):

- definimi i nocioneve për transport të udhëtarëve në komunikacionin rrugor;
- njohja e karakteristikave themelore gjatë transportit të udhëtarëve në komunikacionin rrugor;
- dallimi i llojeve dhe pjesëve të linjës në komunikacion;
- krahasimi i elementeve statike dhe dinamike të linjës;
- identifikimi i orareve të vozitjes në komunikacionin rrugor;
- nxjerrja e përfundimit për punën e shërbimit dispeçer në ndërmarrjet e komunikacionit rrugor;
- organizimi i punës në komunikacionin rrugor ngarkues;
- analizimi i punës transportuese dhe produktivitetit të parkut vozitës;
- zgjedhja e automjetit të duhur për detyrën transportuese të dhënë;
- definimi i mënyrës së dorëzimit;
- vërtetimi i itinerarit të lëvizjes së automjeteve.

2.2.2. Qëllimet e paketës zgjedhore dy (2)

Paketa zgjedhore dy (2) në programin e provimeve tek faktorët për siguri në komunikacionin rrugor e përbëjnë dy programe mësimore: **Siguria dhe rregullimi i komunikacionit rrugor**, që mësohet në vitin e **tretë** dhe **Siguria dhe rregullimi i komunikacionit rrugor**, që mësohet në vitin e **katërt**. Në vazhdim janë definuar qëllimet e të dy programeve mësimore të cilat e përbëjnë paketën zgjedhore dy (2):

- përshkrimi i mjeteve për rregullimin e komunikacionit rrugor;
- zbatimi i rregullave dhe rregulloreve gjatë veprimeve me automjet në komunikacion;
- zbatimi i rregullave dhe rregulloreve që kanë të bëjnë me këmbësorët dhe biçiklistët;
- shpjegimi i rolit të njeriut, automjetit dhe rrugës si faktorë për sigurinë në komunikacion;
- definimi i terminologjisë themelore të lidhura me qarkullimin në komunikacion;
- shpjegimi i karakteristikave të inçizimit në komunikacion;
- përcaktimi i regjimit të lëvizjes në komunikacion në udhëkryqe dhe tempimi i sinjaleve ndriçuese;
- përshkrimi i procedurës gjatë kryerjes së inspektimit të aksidentit në komunikacion;
- shpjegimi i elementeve të ekspertizës teknike-komunikacionit.

3. PËRMBAJTJA E PROVIMIT

3.1. Specifikimi i përmbajtjes dhe aftësive të programit të provimeve

	Numri i modulit	Emri i modulit	Emri i programit mësimor	Viti i mësimit	Fondi i orëve javore/vjetore	Numri i ECVET kredive
Paketa zgjedhore 1	M ₁	Organizimi i transportit	PM ₁ – Organizimi i komunikacionit rrugor	tretë	3/108	7
			PM ₂ – Organizimi i komunikacionit rrugor	katërt	2/66	4
Paketa zgjedhore 2	M ₂	Faktorët për siguri në komunikacionin rrugor	PM ₁ – Siguria dhe rregullimi në komunikacionin rrugor	tretë	108/8	8
			PM ₂ – Siguria dhe rregullimi në komunikacionin rrugor	katërt	132/8	8

Më poshtë janë grupuar dhe janë dhënë aftësitë të cilat nxënësi duhet ti posedojë për zgjidhjen me sukses të detyrave në provim:

- **C1 – njohuritë dhe të kuptuarit** (identifikimi, njohja, emërtimi, renditja, rrethimi, lidhja, nënvizimi, regjistrimi, numërimi);
- **C2 - zbatimi** (dallimi, lidhja, përshkrimi, shpjegimi, dhënia e shembujve, plotësimi, konstruimi, modifikimi);
- **C3 – zgjidhja e detyrave** (klasifikimi, kategorizimi, zhvillimi, revidimi, organizimi, dallimi, analizimi dhe përfundimi).

3.2. Konkretizimi i rezultateve nga mësimi për njësitë modulare

Paketa zgjedhore një (1)

PROGRAMI MËSIMOR 1: Organizimi i komunikacionit rrugor për vitin e tretë	
<i>Njësitë modulare</i>	<i>Rezultatet nga mësimi</i>
	Nxënësi do të jetë i/e aftë të:
1.1. Nocionet themelore gjatë transportit të udhëtarëve në komunikacionin rrugor	– definon nocionin për transportin rrugor të udhëtarëve; – përshkruan ndarjet e transportit të udhëtarëve;
1.2. Karakteristikat e transportit të udhëtarëve në komunikacionin rrugor	– analizon karakteristikat e lëvizjes së udhëtarëve; – identifikon llojet e nevojave të transportit në linjë;
1.3. Rruga transportuese gjatë transportit të udhëtarëve në komunikacionin rrugor	– shpjegon nocionit për linjat e komunikacionit, llojet dhe pozitat e ndalesave të linjës; – dallon stacionet e autobusëve dhe nënstacionet e autobusëve;
1.4. Elementet e punës së automjeteve në linja	– përshkruan elementet e punës së automjeteve në linja; – shpjegon elementet dinamike të linjës; – llogarit vlerat e koeficientit për shfrytëzim; – llogarit numrin e nevojshëm të automjeteve për punë në linjë;
1.5. Oraret e vozitjes në komunikacionin rrugor	– përshkruan nocionet për oraret e vozitjes; – identifikon llojet e orareve të vozitjes;
1.6. Shërbime dispeçerik në ndërmarrjet e komunikacionit rrugor	– përshkruan funksionin e shërbimit dispeçerik; – identifikon obligimet dhe detyrat e shërbimit dispeçerik.
PROGRAMI MËSIMOR 2: Organizimi i komunikacionit rrugor për vitin e katërt	
<i>Njësitë modulare</i>	<i>Rezultatet nga mësimi</i>
	Nxënësi do të jetë i/e aftë të:
1.1. Organizimi i komunikacionit rrugor ngarkues	– shpjegon klasifikimin e komunikacionit rrugor ngarkues; – analizon parametrat për organizimin e komunikacionit linjor;
1.2. Autoparku i ndërmarrjes transportuese dhe elementet e punës transportuese të autoparkut	– përshkruan nocionet themelore dhe ndarjet e autoparkut të ndërmarrjeve transportuese; – analizon punën transportuese dhe procesin transportues;
1.3. Puna transportuese dhe produktiviteti i autoparkut në funksion të treguesve të punës së automjeteve	– llogarit punën transportuese; – dallon llojet e produktivitetit të autoparkut;
1.4. Zgjedhja e rrugës transportuese dhe automjetit transportues gjatë realizimit të detyrave transportuese	– shpjegon mënyrën e zgjedhjes së rrugës transportuese gjatë realizimit të detyrave transportuese; – shpjegon mënyrën e zgjedhjes së automjetit transportues gjatë realizimit të detyrave transportuese.

Paketa zgjedhore dy (2)

PROGRAMI MËSIMOR 1: Siguria dhe rregullimi i komunikacionit rrugor – viti tretë	
<i>Njësitë modulare</i>	<i>Rezultatet nga mësimi</i>
	Nxënësi do të jetë i/e aftë të:
2.1. Sinjalizimi në komunikacion	- definojnë mjetet për rregullimin e komunikacionit rrugor; - shpjegojnë qëllimin e shenjave ndriçuese në komunikacion;
2.2. Rregullat dhe rregulloret në komunikacion	- shpjegojnë rëndësinë e rregullave gjatë veprimeve të caktuara me automjet në komunikacion; - definojnë karakteristikat e këmbësorëve në komunikacion; - definojnë karakteristikat e biçiklistëve në komunikacion;
2.3. Faktorët për siguri në komunikacion	- analizon njeriun si faktorë për siguri në komunikacion; - analizon automjetin si faktor për siguri në komunikacion; - analizon rrugën si faktor për siguri në komunikacion.
PROGRAMI MËSIMOR 2: Siguria dhe rregullimi i komunikacionit rrugor – viti katërt	
<i>Njësitë modulare</i>	<i>Rezultatet nga mësimi</i>
	Nxënësi do të jetë i/e aftë të:
2.4. Madhësitë themelore të qarkullimit në komunikacion	- llogarit vlerat për madhësitë themelore të qarkullimit në komunikacion; - përshkruan karakteristikat e qarkullimit në komunikacion; - llogarit vlerat për varësinë ndërmjet madhësive themelore të qarkullimit në komunikacion;
2.5. Inçizimi në komunikacion	- shpjegojnë numërimin manual dhe automatik në komunikacion; - shpjegojnë numërimet në komunikacion në pikë pagesat dhe parkingjet;
2.6. Zhvillimi i komunikacionit në udhëkryqe	- shpjegojnë nocionet për mënyrat dhe sistemet e punës së pajisjeve të sinjaleve ndriçuese; - përshkruan konceptin e rregullimit të komunikacionit të centralizuar, decentralizuar dhe të kombinuar;
2.7. Inspektimi në rast të aksidentit rrugor	- definojnë dokumentacionin teknik nga inspektimi i kryer;
2.8. Ekspertiza teknike-komunikacionit	- llogarit vlerat e nevojshme gjatë kryerjes së inspektimit në aksident në komunikacion; - llogarit vlerat në rast të aksidentit ndërmjet dy automjeteve.

4. RRJETI I SPECIFIKIMIT TË PROVIMIT

Në rrjetin e specifikimeve të provimit jepet një skemë e përfaqësimit në përqindje të njësive mësimore dhe aftësive në test. Numri i detyrave të provimit nga çdo njësi mësimore, që përfshin një grup të caktuar aftësish, do të jetë i përshtatshëm me përqindjen e përfaqësimit të tyre në raport me numrin total të detyrave të provimit që do të përmbajë testi. Gjatë përgatitjes së testit për zbatimin e brendshëm të provimit, komisioni i provimit të shkollës ruan përqindjen e përfaqësimit të pyetjeve të provimit për lëndët që janë pjesë e paketës me zgjedhje, por ka fleksibilitet në përcaktimin e numrit të pyetjeve për njësitë modulare që janë pjesë e njësive mësimore, pra njësit mësimore nga paketa zgjedhore. Rrjetet e veçanta të specifikimeve janë duke u zhvilluar për dy paketave zgjedhore.

4.1. Rrjeti i specifikimeve të paketës zgjedhore një (1)

AFTËSITË	PROGRAMET MËSIMORE		PËRFQËSIMI (%)
	PZ ₁	PZ ₂	
C 1	20 - 30 %	20 - 30 %	40 - 60 %
C 2	15 - 25 %	5 - 15 %	20 - 40 %
C 3	5 - 15 %	5 - 15 %	10 - 30 %
PËRFAQËSIMI (%)	50 - 60 %	40 - 50 %	100 %

C1 – njohuri dhe të kuptuarit (identifikimi, njohja, emërtimi, renditja, rrethimi, lidhja, nënvizimi, regjistrimi, numërimi);

C2 – aplikimi (dallimi, lidhja, përshkrimi, shpjegimi, dhënia e shembujve, plotësimi, konstruimi, modifikimi);

C3 – zgjidhje e detyrave (klasifikimi, kategorizimi, zhvillimi, rishikimi, organizimi, renditja, krahasimi, analizimi, përfundimi, zgjidhja e problemeve konkrete).

PZ₁ – Organizimi i komunikacionit rrugor për vitin e tretë

PZ₂ – Organizimi i komunikacionit rrugor për vitin e katërt

4.2. Rrjeti i specifikimeve të paketës zgjedhore dy (2)

AFTËSITË	PROGRAMET MËSIMORE		PËRFAQËSIMI (%)
	PZ ₁	PZ ₂	
C 1	20 - 30 %	20 - 30 %	40 - 60 %
C 2	5 - 15 %	15 - 25 %	20 - 40 %
C 3	5 - 15 %	5 - 15 %	10 - 30 %
PËRFAQËSIMI (%)	40 - 50 %	50 - 60 %	100 %

C1 – njohuri dhe të kuptuarit (identifikimi, njohja, emërtimi, renditja, rrethimi, lidhja, nënvizimi, regjistrimi, numërimi);

C2 – aplikimi (dallimi, lidhja, përshkrimi, shpjegimi, dhënia e shembujve, plotësimi, konstruimi, modifikimi);

C3 – zgjidhje e detyrave (klasifikimi, kategorizimi, zhvillimi, rishikimi, organizimi, renditja, krahasimi, analizimi, përfundimi, zgjidhja e problemeve konkrete).

PZ₁ – Siguria dhe rregullimi i komunikacionit rrugor për vitin e tretë

PZ₂ – Siguria dhe rregullimi i komunikacionit rrugor për vitin e katërt

5. PËRSHKRIMI I PROVIMIT

Provimi për profilin/kualifikimin arsimor Teknik për komunikacion rrugor zhvillohet me shkrim me mundësi përdorimi të TIK-ut. Nxënësi zgjedh njërën nga dy paketat modulare të ofruara për të cilat ka përgatitur detyrat e provimit.

Provimi konsiston në zgjidhjen e një testi. Testi përmban rreth **40** detyra provimi.

Kohëzgjatja e provimit është **120 minuta** dhe zhvillohet nga bordi i provimit të lëndës në shkollë pa pushim..

Tre lloje të detyrave të provimit janë të përfaqësuara në test:

- detyrat në të cilat nxënësi duhet të zgjedhë një të saktë nga përgjigjet e dhëna;
 - detyra të lidhura dhe detyra të hapura - detyra në të cilat duhet të shkruhet një përgjigje e shkurtër në vendin e shënuar;
- detyrat në të cilat nxënësi duhet të tregojë të gjithë procedurën e zgjidhjes së detyrës së dhënë.

Gjatë kohës së provimit është e lejuar të përdoret kalkulator.

6. MËNYRA E NOTIMIT

Numri i përgjithshëm i pikëve që mundet të fitohen në provimin e profilit/kualifikimit arsimor **Teknik për komunikacion rrugor** është rreth **70**.

Përgjigja e saktë tek detyrat me zgjedhje të shumëfishtë dhe detyrat me lidhje vlerësohen me 1 pikë për çdo përgjigje të saktë. Përderisa i zgjidh saktë të gjitha detyrat, nxënësi mundet të fitojë rreth **20-30 pikë**.

Përgjigja e saktë në detyrat ku kërkohet përgjigje direkte (me një fjalë, numër ose frazë), vlerësohet me 2 pikë për çdo përgjigje të saktë. Me zgjidhjen e saktë të këtij lloji të detyrave nxënësi mundet të fitojë rreth **20-30 pikë**.

Në detyrat në të cilat kërkohet që të tregohet si zgjidhet ndonjë detyrë (situatë e komplikuar), të diskutohet, të shpjegohet, të zgjidhet, gjatë së cilës vlerësohet e saktë çdo fazë e detyrës. Këto detyra vlerësohen me **3-5 pikë**. Te detyrat e këtilla, nëse i zgjedh saktë, nxënësi mundet të fitojë nga **15 deri 25 pikë**.

Notimi do të kryhet **në mënyrë interne nga ana e komisionit shkollor lëndor**, në bazë të udhëzimeve të përgatitura më herët dhe kriterëve të përputhura.

7. NËNSHKRIMI DHE DATA E MIRATIMIT TË PROGRAMIT TË PROVIMEVE

Programin i provimeve për maturën shtetërore dhe provimin përfundimtar, nga modulet e obligueshme në arsimin profesional për profilin/kualifikimin arsimor **Teknik për komunikacion rrugor** nga arsimi i mesëm teknik i reformuar nga drejtimi/sektori Komunikacion, Transport dhe Magazinin për nxënësit e arsimit të mesëm profesional, me mendim pozitiv nga Byroja për Zhvillimin e Arsimit, nr. 08-17/18, më 19.4.2022, e miratoi ministri i Arsimit dhe Shkencës.

Numri: 13-5400 / 21

Data: 05.05.2022

Ministër i Arsimit dhe Shkencës,

Doc. Dr. Jeton Shaqiri

n.p.

**Vula e rumbullakët:
Republika e Maqedonisë së Veriut
Ministria e Arsimit dhe Shkencës - Shkup**